



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, më datë **04.06.2024** janë paraqitur 4 kërkesa penale: ankuesi **1) Stojan Angjellari**; Nr. 332 Regj.Themeltar, datë regjistrimi 03.06.2024 me objekt: Ankim kundër sekuestros së provës materiale (aparatur celular) në pronësi të shtetasit **Stojan Angjellari**, sipas procesverbalit të datës 21.05.2024. Konstatimin e shkeljeve të urdhërimeve të gjykatës nga ana e Oficerëve të Policisë Gjyqësore gjatë procesit të kontrollit dhe sekuestrimit. Kthimin e sendit të sekuestruar aparat celulari i markës I-phone model 13, me kapak me ngjyrë blu shtetasit **Stojan Angjellari**; **2) ankuesi Migel Zallëmi** Nr. 333 Regj.Themeltar, datë regjistrimi 03.06.2024 me objekt: Ankim kundër sekuestros së provës materiale (aparatur celular) në pronësi të shtetasit **Migel Zallëmi**, sipas procesverbalit të datës 21.05.2024. Konstatimin e shkeljeve të urdhërimeve të gjykatës nga ana e Oficerëve të Policisë Gjyqësore gjatë procesit të kontrollit dhe sekuestrimit. Kthimin e sendit të sekuestruar aparat celulari i markës Xiaomi model Redmi Note model 10 Pro, me kapak me ngjyrë zezë shtetasit **Migel Zallëmi**; **3) ankuese Ela Strazimiri**; Nr. Regj.Them. 330; datë regjistrimi 03.06.2024 me objekt: Ankim kundër sekuestros së provës materiale (aparatur celular) në pronësi të shtetasës **Ela Strazimiri**, sipas procesverbalit të datës 21.05.2024. Konstatimin e shkeljeve të urdhërimeve të gjykatës nga ana e Oficerëve të Policisë Gjyqësore gjatë procesit të kontrollit dhe sekuestrimit. Kthimin e sendit të sekuestruar aparat celulari i markës I-phone model 14 Pro, me kapak me ngjyrë gri shtetasës **Ela Strazimiri**; **4) ankuese Shoqëria “Messer Albagaz” sh.p.k**, Nr. 330 Regj.Themeltar, datë regjistrimi 04.06.2024 me objekt: “Kundërshtim i veprimeve të Oficerit të Policisë Gjyqësore për Kontrollin dhe sekuestrimin e provave materiale kryer në datë 21.05.2024, pranë ambienteve të shoqërisë “Meser Albagaz” sh.p.k. Kthimin e sendeve të sekuestruara në datë 21.05.2024, në ambientet e shoqërisë “Messer Albagaz” sh.p.k.

2. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendim të ndërmjetëm vendosi: Bashkimin e kërkesave penale, **si një kërkesë e vetme.** Në përfundim të gjykimit, Gjykata me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Bani, me vendimin Nr. **330**, datë 14.06.2024, vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesave si të pabazuar në ligj.
2. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen ankuesve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë, më datë 14.06.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar